



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM

VENDIM

Nr.33, datë 20/09/2023

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR AUTORIZIM “PËR
SHKARKIMIN E UJËRAVE TË PËRDORUR INDUSTRIAL”,
SHOQËRISË “HAKO” SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për autorizim “Për shkarkimin e ujërave të përdorur industrial”, subjektit “Hako” sh.p.k, me vendndodhje, Njësia Administrative Kashar, Bashkia Tiranë, sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit janë si më poshtë:

Pika e shkarkimit

- X= 479469.86
- Y= 4579682.19
- Z= 61 m.m.n.d

Prurja që shkarkohet: $Q=0.67$ l/sek

Pika e monitorimit të cilësisë së ujit të shkarkuar:

- X= 479469.86
- Y= 4579682.19
- Z- 61 m.m.n.d

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBU ISHËM

EMILJAN JANI

